



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .11.2022

**MBLEDHJA Nr. 53,**  
**Datë 18.11.2022, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 18.11.2022, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 53 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 07.11.2022 dhe datë 10.11.2022
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&E Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
3. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 505, seria P22, të shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW”
5. Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 90, datë 06.08.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.”, i ndryshuar
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nr. 210, seria PV13K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 01.10.2013”
7. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kuç” me kapacitet të instaluar 1930 kW”

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të

dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**